



**Strategjia e Zgjerimit dhe Sigurimit
të Cilësisë për Universitetin e Prizrenit
“Ukshin Hoti”**

Prizren, 2013

Stafi i Universitetit të Prizrenit i përfshirë në zhvillimin e dokumentit:

Prof. Asoc. Dr. Mazllum Baraliu, Rektor

Dr. Sc. Behxhet Mustafa, Prorektor për Mësimdhënie dhe Hulumtim Shkencor

Prof. Dr. Behxhet Brajshori

Dr. Ismet Temaj

Dr. Bashkim Zahiti

Dr. Ermir Rogova

Dr. Florije Govori

Dr. Gani Gjini

Dr. Xheladin Zymberaj

Dr. Shkelqim Millaku

Dr. Sadik Idrizi

MSc. Ercan Canhasi

MSc. Münevver Muyo

Adem Sallauka, Sekretar Permanent

Jasmin Jusufi, Koordinator i Sigurimit të Cilësisë

Durim Latifi, Kryesuer i Parlamentit të Studentëve

Demine Haxhimurati, Anëtar i Parlamentit të Studentëve

Përfaqësuesit e partnerëve të projektit të përfshirë në zhvillimin e dokumentit:

Volker Gehmlich, But Dedaj, Tina Harrison, Linda Bruce, Mjellma Carabregu, Magui Perez Cabani, Michaela Handke, Josep Juandobosch, Luljeta Aliu, Sari Scheinberg, Alfred Marleku

Zhvillimi dhe publikimi i Strategjia e Zgjerimit dhe Sigurimit të Cilësisë për Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti" është financuar në kuadër të projektit TEMPUS "Përkrahja Strategjike për Zhvillimin e Strukturave të Qëndrueshme të SC në Universitetin e Sapo Financuar Publikisht në Kosovë, Universitetin e Prizrenit" no. 517482.



Tempus

Ky projekt është financuar me përkrahjen e Komisionit Evropian. Ky publikim reflekton vetëm këndvështrimet e autorit, dhe Komisioni nuk mund të mbahet përgjegjës për çfarëdo përdorimi të informatave të përfshira në të.

PËRMBAJTJA

Hyrje nga Rektori	5
Misioni i Universitetit të Prizrenit	7
Vizioni.....	7
1. Principet Udhëzuese të Strategjisë së Zgjerimit dhe Sigurimit të Cilësisë në Universitetin e Prizrenit	8
<i>1.1 Efektiviteti dhe Efikasiteti.....</i>	<i>8</i>
<i>1.2 Roli i Menaxhmentit, stafit akademik dhe administrativ.....</i>	<i>9</i>
<i>1.3 Pjesëmarrja e studentëve në organet qeverisëse.....</i>	<i>10</i>
<i>1.4 Shërbimet e Përkrahjes Studentore</i>	<i>11</i>
<i>1.5 Promovimi i Lëvizshmërisë akademike dhe Studentore.....</i>	<i>12</i>
<i>1.6 Garantimi i transparencës, lirisë së studimit dhe hulumtimit artistik dhe shkencor,respektimi i studimit përfshirës.....</i>	<i>13</i>
<i>1.7 Pajtueshmëria dhe krahasimi i programeve studimore me standardet dhe udhëzimet Evropiane.....</i>	<i>13</i>

2. Implementimi i Strategjisë së Zgjerimit dhe Sigurimit të Cilësisë në Universitetin e Prizrenit	14
<i>2.1 Zyra e Sigurimit të Cilësisë.....</i>	<i>14</i>
<i>2.2 Instrumentet e Sigurimit të Cilësisë</i>	<i>14</i>
3. Vlerësimi dhe azhurnimi i strategjisë.....	15

HYRJE NGA REKTORI

Strategjia e sigurimit të cilësisë është dokumenti i parë i zhvillimit strategjik në UPZ, i cili përcakton prioritetet bazë të arsimit të lartë në fushën e sigurimit të cilësisë dhe mënyrat e realizimit të tij. Ky punim shënon natyrën relevante dhe permanente të Universitetit e cila njëkohësisht, duke u varur në nevojat dhe arsyet e mundshme, mund të rishikohet dhe ndryshohet periodikisht, e shtuar respektivisht dhe të mund të shërbejë si një hartim i planeve të veprimit në afatin e shkurtët, të mesëm dhe të gjatë në fushën e sigurimit të cilësisë.

Duke marrë parasysh se arsimi i lartë është themel i bazuar në zhvillim social, dituri si dhe në zhvillim ekonomik dhe kulturor e të cilat janë bazat e progresit të të drejtave njerëzore e misioni i Universitetit të Prizrenit është mundësimi dhe zhvillimi i standardeve të arsimit të lartë, ofrimi i korpuseve të njohurisë dhe aftësive të arritura në fushat përkatëse akademike, shkencore dhe hulumtuese në pajtueshmëri me nevojat e shoqërisë, tregut të punës si dhe progresit dhe prosperitetit të përgjithshëm shoqëror të pasqyruar për të ardhmen.

Për të përmbushur misionin e vet, Universiteti është i vendosur në një mënyrë permanente dhe konsistente të aspirojë avancim të cilësisë më të lartë në arsimin e lartë dhe integrim në sistemin dhe hapësirën e unifikuar të arsimit të lartë Evropian.

Qëllimi kryesor për draftimin e kësaj strategjie është arritja e qëllimeve të prezantuara juridike dhe vizionit të zhvillimit të mëtutjeshëm të arsimit të lartë në universitet dhe jashtë.

Në mënyrë që të arrijë qëllimet thelbësore afatgjate, Universiteti është i angazhuar në pikat vijuese:

- Progresi i cilësisë gjithëpërfshirëse të arsimit të lartë në universitet dhe programet e tij.
- Zgjerimi i efikasitetit studimor.
- Përmirësimi i cilësisë në programet studimore, mësimdhënien dhe mësimnxënien dhe kushtet e punës.
- Përmirësimi i hulumtimit shkencor dhe punës pedagogjike të stafit akademik të universitetit.
- Rritja e kontributit, jetës akademike të Universitetit dhe kontributit i cili ofrohet në komunitetin lokal dhe Kosovar në përgjithësi.

Sinqerisht,

Prof. Asoc. Dr. Mazllum Baraliu

Misioni i Universitetit të Prizrenit

Universiteti i Prizrenit i shërben regjionit të Prizrenit dhe Republikës së Kosovës duke regjistruar, zhvilluar dhe edukuar studentët drejt të qenit diplomatë të suksesshëm për tregun e punës në Kosovë, rajon dhe Evropë.

Vizioni

Universiteti i Prizrenit është i dedikuar ndaj zgjerimit të cilësisë së mësimnxënies, mësimdhënies, dhe hulumtimit në Universitet, në mënyrë që të jetë i krahasueshëm dhe i përshtatshëm me institucionet e tjera të arsimit të lartë në rajon dhe në Fushën e Arsimit të Lartë Evropian.

Në mënyrë që të asistojë në arritjes e misionit dhe vizionit të vet për të ardhmen, Universiteti i Prizrenit (UPz) ka dizajnuar Strategjinë e Zgjerimit dhe Sigurimit të Cilësisë. Strategjia krijon bazën për procedurat e brendshme dhe të jashtme të sigurimit të cilësisë në Universitet.

1. Principet Udhëzuese të Strategjisë së Zgjerimit dhe Sigurimit të Cilësisë në Universitetin e Prizrenit

Institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë, përfshirë Universitetin e Prizrenit (UPz), janë të përkrahura në mënyre ligjore nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë (MASHTK), për të kryer, zhvilluar, formuar dhe vlerësuar qëndrueshëm reformat bazuar në principet vijuese: efektiviteti dhe efikasiteti; roli i menaxhmentit, stafit akademik dhe administrativ; pjesëmarrja e studentëve në organet qeverisëse; përkrahja studentore; promovimi i lëvizshmërisë akademike dhe studentore; krijimi i mundësive për zhvillim të stafit; bashkëpunimi me palët relevante me interes; garantimi i transparencës, lirisë së studimit dhe hulumtimit artistik dhe shkencor, respektimi i edukimit përfshirës; pajtueshmëria dhe krahasimi i programeve studimore me standardet dhe udhëzimet Evropiane; përgjegjësia sociale institucionale.

1.1 Efektiviteti dhe efikasiteti

Universiteti i Prizrenit është themeluar nga MASHTK (ns. 153/02-1) dhe është akredituar nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës. Është e dedikuar ndaj sigurimit dhe krijimit të gjeneratave të reja të të diplomuarve, duke i pajisur ata me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme profesionale, shkencore dhe kreative të nivelit të njohur cilësor bazuar në Kornizën e Kualifikimit Kombëtar (KKK). Universiteti i Prizrenit duke u bazuar në

statutin e vet mundëson regjistrimin e studentëve të cilët do të jenë të motivuar dhe në gjendje të mësojnë, të kryejnë hulumtime artistike dhe shkencore, të punojnë në mënyrë të pavarur, të jenë kreativ dhe inovativ. Qëllimi është krijimi i ambientit të nevojshëm mësimor duke përfshirë infrastrukturën e brendshme dhe të jashtme, duke identifikuar kompetencat dhe resurset e nevojshme për të promovuar, lehtësuar dhe arritur punësimin e të diplomuarve tanë brenda dhe jashtë vendit. Universiteti i Prizrenit ka për qëllim të arrijë synimet e lartpërmendura në mënyrën më efikase të mundshme. Për këtë arsye, sigurimi i vazhdueshëm i sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit të cilësisë, digjitalizimi i përgjithshëm i mësimdhënies, mësimnxënies dhe administrimit do të jetë në vend.

1.2 Roli i menaxhmentit, stafit akademik dhe stafit administrativ

Menaxhmenti

Qeverisja e Universitetit të Prizrenit përbëhet nga:

- a. Bordi
- b. Rektori
- c. Senati dhe
- d. Dekanët

Organet e lartpërmendura janë përgjegjëse për zgjerimin dhe implementimin e sigurimit të cilësisë. Përgjegjësitë e tyre janë të përcaktuara qartë në statutin e universitetit.

a. Stafi akademik

Stafi akademik performon në një mënyrë profesionale në arsimin e universitetit dhe është i obliguar të mësojë, hulumtojë, publikojë dhe marrë pjesë në konferencat dhe seminarët e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Ata zhvillojnë veten drejt të qenit të informuar me zhvillimet e fundit brenda fushës shkencore dhe të ofrimit të dijes, aftësive dhe kompetencave tek studentët e UPz dhe të kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë.

b. Stafi administrativ

Stafi administrativ përkrah mësimdhënien, mësimnxënien e hulumtimit dhe dokumenton aktivitetet, informacionet dhe komunikon rezultatet e UPz. Ata janë përgjegjës për implementimin e politikave dhe vendimeve të marra nga autoritetet përkatëse. Ata duhet të trajnohen dhe të zhvillojnë veten në përputhje me rrethanat.

1.3 Pjesëmarrja e studentëve në organet qeverisëse

Universiteti është i udhëhequr nga principet e transparencës, lirisë së komunikimit dhe një ndërlidhje të të gjitha niveleve të institucionit: nivelit menaxherial, stafit akademik dhe administrativ, të cilët bashkëpunojnë ngushtë me studentët (bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë në Kosovë, nr. 31). Bashkëpunimi me studentët, përfaqësuesit e tyre përkatës për çështje të përgjithshme dhe specifike si dhe për projekte dhe iniciativa të ndryshme, ndodh në bazë të rregullt. UPz siguron që studentët do të jenë në gjendje të marrin pjesë në mënyrë aktive

në zhvillimin e universitetit duke ofruar trajnim dhe hapësira adekuate.

Udhëheqësit e Unioneve Studentore duhet të pranohen me ligj dhe të zgjidhen nga studentët e rregullt të UPz. Ligji për Arsim të Lartë në Kosovë krijon bazën që studentët të kenë një rol aktiv si individë ose kolektivisht, në mënyrë që jeta e studentëve të bëhet më atraktive dhe inspiruese për studentët për mësimnxënien dhe hulumtimin kreativ.

Të gjithë Udhëheqësit e Unioneve Studentore (artikulli 2 i Ligjit për Arsimin të Lartë në Kosovë, nr. 1.8), të cilët janë të zgjedhur me ligj sipas të gjitha rregullave dhe rregulloreve institucionale, janë të barabartë para Ligjit. Këto lloje të organizatave janë të obliguara të organizojnë aktivitete të ndryshme edukative dhe shkencore në institucion.

UPz vlerëson pjesëmarrjen e studentëve në të gjitha nivelet e institucioneve dhe aktivisht synon të përfshijë studentët në proceset e veta të cilësisë duke organizuar procese të rregullta të vlerësimit. UPz njeh rëndësinë e mendimit të tyre, i cili do të shërbejë për zgjerimin e cilësisë.

1.4 Shërbimet e Përkrahjes Studentore

Universiteti i Prizrenit është i angazhuar të ofrojë të gjitha pajisjet për të përkrahur studentët në mësimnxënie, avancim të karrierës, nevoja shoqërore dhe në veçanti në kohezion shoqëror.

1.5 Promovimi i lëvizshmërisë akademike dhe studentore

Zhvillimi i rrjeteve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe pjesëmarrja në asociacione të ndryshme është një nga detyrat kryesore të Universitetit të Prizrenit. Lëvizshmëria hyrëse dhe dalëse e stafit akademik dhe studentëve siguron një shkëmbim të vazhdueshëm të eksperiencave për të rritur bashkëpunimin akademik dhe për të përfituar nga diversiteti kulturor. Institucioni promovon dhe forcon format vijuese të lëvizshmërisë:

- a. Lëvizshmëria e studentëve, ligjëruesve dhe bursistëve të fakultetit, përmes marrëveshjeve kombëtare dhe ndërkombëtare të bashkëpunimit;
- b. Pjesëmarrja në arsim, trajnime dhe programe hulumtuese regjionale dhe ndërkombëtare;
- c. Zhvillimi i diplomave të përbashkëta, programeve studimore dhe projekteve hulumtuese;
- d. Pjesëmarrja në shkolla verore dhe/ose ngjarje të ngjashme;
- e. Promovimi dhe lehtësimi i angazhimit të dijes së diasporës;
- f. Promovimi i rezultateve të ndryshme shkencore në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar (libra, magazina, revista, burime elektronike);
- g. Hyrja në fuqi e dritareve të lëvizshmërisë në të gjitha programet studimore;

Universiteti do të konsiderojë çfarëdo opsioni tjetër të lëvizshmërisë dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

1.6 Garantimi i transparencës, lirisë së studimit dhe hulumtimit artistik dhe shkencor, respektimi i studimit përfshirës

Universiteti i Prizrenit është institucion autonom dhe ka liri të plotë akademike të mundësuar nga ligji (Ligji për Arsim të Lartë në Kosovë, nr. 27). Institucioni do të ofrojë transparencë dhe liri akademike, hulumtim shkencor dhe artistik në të gjitha komunitetet që jetojnë në Republikën e Kosovës, si dhe për studentët dhe hulumtuesit nga jashtë të interesuar të studiojnë dhe punojnë në UPz. Ligji për Arsim të Lartë në Kosovë n.04/L-037, i cili është i bazuar në Artikullin 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, thotë se “askush nuk duhet të diskriminoj në bazë gjinore, racore, gjuhësore, religjioze, politike ose ndonjë opinionin tjetër, kombëtar ose me origjinë sociale, relacion me ndonjë komunitet, pronësi, gjendje ekonomike dhe sociale, orientim seksual, lindje, paaftësi ose status tjetër personal”¹. UPz është plotësisht e vetëdijshme për përgjegjësinë sociale të institucionit të vet dhe nxitë edukimin përfshirës.

1.7 Pajtueshmëria dhe krahasimi i programeve studimore me standardet dhe udhëzimet Evropiane

Përmes akreditimit të jashtëm të institucionit dhe programeve, UPz do të arrijë pajtueshmëri me kërkesat e Fushës së Arsimit të Lartë Evropian. Ky proces do të zgjerojë mundësitë për të diplomuarit që të vazhdojnë studimet e tyre në universitete të ndryshme rajonale, Evropiane dhe mbarëbotërore.

1 Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë, neni 22, pika 3.2; 9 shtator 2011.

2. Implementimi i Strategjisë së Zgjerimit dhe Sigurimit të Cilësisë në Universitetin e Prizrenit

2.1 Zyra e Sigurimit të Cilësisë

Në Mars 2012, Menaxhmenti i Universitetit të Prizren ka krijuar Zyrën e Sigurimit të Cilësisë me detyrën e lehtësimit të implementimit të principeve të listuara më lartë.

Në nivelin kombëtar dhe Evropian, Universiteti i Prizrenit është i angazhuar të përdor si dokumente udhëzuese brenda Fushës së Arsimit të Lartë Evropian si dhe atyre të Republikës së Kosovës:

1. Deklaratën e Bolonjës;
2. "Standardet dhe Udhëzimet e Sigurimit të Cilësisë në Fushën e Arsimit të Lartë Evropian", Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (AESC)
3. Konventa e Lizbonës;
4. Ligji i Kosovës për Arsimin e Lartë;
5. Udhëzimet e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës.

2.2 Instrumentet për sigurimin e cilësisë

Instrumentet vijuese të pamatshme (kualitative) dhe të matshme (kuantitative) përdoren për të siguruar dhe zgjeruar cilësinë:

1. Pyetësorët
2. Intervistat
3. Monitorimi
4. Skemat e vlerësimit
5. Raportet vet-vlerësuese

Dhe çdo instrument tjetër i dobishëm, siç janë: shënimi i dyfishtë, konsulenca e jashtme siç është përcaktuar në dokumentet juridike të universitetit.

3. Vlerësimi dhe azhurnimi i strategjisë

Menaxhmenti i Universitetit do të rishikojë dhe vlerësoj principet dhe implementimin e strategjisë në bazë të rregullt dhe do të ndërmarrë masa korrektuese nëse është e nevojshme.

